

GRUPI



RAPORT STATISTIKOR

JANAR-SHKURT

2026

eurosig.al - insig.com.al

## Tabela e Përmbajtjes

Tregu i sigurimeve, Janar-Shkurt 2026	1
Primet e Shkruara Bruto	1
Dëmet e Paguara	2
Grupi Eurosig – Insig, Janar-Shkurt 2026	3
Prime të shkruara Bruto	3
Sigurimet Motorike	4
Sigurimi TPL	5
Sigurimi Karton Jeshil	5
Sigurimi Kufitare	6
Dëme të paguara	8
Dëmet e sigurimeve motorike	9


## Tregu i sigurimeve, Janar-Shkurt 2026

### Primet e Shkruara Bruto

Tregu i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë për periudhën janar-shkurt 2026 ka shënuar rritje me rreth 3.07% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025. Volumi i primeve të shkruara bruto ka arritur në vlerën 3,927,194 mijë lekë. Struktura e tregut të sigurimeve vijon të mbetet e orientuar drejt sigurimeve të Jo Jetës, ku aktiviteti i Jo Jetës zotëron 90.75% të tregut, ndërsa tregu i Jetës mban 9.25% dhe pjesa e veprimtarisë së risigurimit 0.001%. Ndërkohë, numri i kontratave të lidhura rritet me 0.22%, duke nënshkruar 228,358 kontrata.

**Volumi i primeve të shkruara bruto të tregut të sigurimeve për periudhën janar-shkurt 2026 shënon rritje me 3.07% krahasuar me janar-shkurt 2025.**

Grafiku 1: Struktura e tregut të sigurimeve, janar-shkurt 2026/2025



**Gjatë periudhës janar-shkurt 2026, sigurimet e Jo Jetës shënojnë rritje me 3.31% krahasuar me janar-shkurt 2025.**

Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës realizon 3,563,902 mijë lekë prime të shkruara bruto, në rritje me 3.31% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025. Rritja vjen kryesisht nga sigurimet e detyrueshme motorike, të cilat përbëjnë afro 66.80% të totalit të primeve. Numri i kontratave të lidhura është në rritje me 0.07%, duke nënshkruar 204,141 kontrata.


**Shënohet rritje me 8.50% në vlerën e dëmeve të paguara të tregut të sigurimeve,dhe rritje me 5.68% në numrin i dëmeve të paguara.**

### Dëmet e Paguara

Vlera e dëmeve të paguara të tregut të sigurimeve është 1,376,983 mijë lekë, duke shënuar rritje me 8.50% krahasuar me janar-shkurt 2025. Nga totali i dëmëve të tregut 93.39% e këtyre dëmeve të paguara janë nga aktiviteti i Jo Jetës, 3.76% nga aktiviteti i Jetës dhe 2.85% nga dëmet e paguara të fondit të kompensimit. Nga aktiviteti i Jetës, dëmet e paguara janë në rënie krahasuar me periudhën janar-shkurt të vitit 2025, përkatësisht me 37.27% ndërsa nga Jo Jeta janë me rritje me 15.91%. Dëmet e fondit të kompensimit rezultojnë me rënie prej 49.15%.

Numrit i dëmeve të paguara për tregun është 12,799 raste dhe krahasuar me janar-shkurt 2025 rezulton me një rritje prej 5.68% ose 688 dëmë më shumë. Numri i rasteve nga aktiviteti i Jo Jetës është 12,123 raste, me një rritje prej 4.22% ose 491 dëme të paguara më shumë krahasuar me vitin 2025.

Grafik 2: Dëme të paguara tregu i sigurimeve, , janar-shkurt 2026



**Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës rezulton me rritje në vlerën e dëmeve të paguara prej 15.91% dhe rritje në numrin e dëmeve të paguara me 4.22% krahasuar me janar-shkurt 2025.**

## Grupi Eurosig – Insig, Janar-Shkurt 2026


Në grupin e sigurimeve Eurosig – Insig të trajtuara në këtë raport përfshihen shoqëritë Eurosig Shqipëri dhe Insig Jo Jetë.

**Volumi i primeve të shkruara bruto të Grupit Eurosig – Insig shënon rritje me 3.56% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025.**

### Prime të shkruara Bruto

Vlera e primeve të shkruara bruto të grupit për periudhën janar-shkurt 2026 arrin në 730,407 mijë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, primet e realizuara të grupit janë në rritje me 3.56%, rezulton 0.25% më shumë se norma e tregut. Në tregun e Jo Jetës grupi renditet në vendin e tretë dhe zotëron 20.49% të totalit të primeve të shkruara bruto. Në të njëjtën linjë me tregun edhe grupi është i orientuara drejt sigurimeve të detyrueshme motorike duke sjellë një raport të sigurimeve vullnetare me motorike të detyrueshme 17.31% me 82.69%. Ndërkohë, raporti i sigurimeve vullnetare ndaj totalit të primeve të tregut për periudhën janar-shkurt 2026 paraqitet 33.20%.

Grafiku 3: Përpjesa e shoqërive ndaj totalit të tregut, janar-shkurt 2026



**Në tregun e sigurimeve të Jo Jetës, Grupi Eurosig – Insig renditet në vendin e tretë, duke zotëruar 20.49% të tregut të Jo Jetës.**


Rritja e përgjithshme e tregut të Jo Jetës është 3.31%, ndërkohë grupi rritet me 3.56%, rritje e ardhur kryesisht nga rritja e sigurimeve të detyrueshme motorike.

**Grupi Eurosig – Insig renditet në vendin e parë në treg në klasën e sigurimeve motorike, duke zotëruar 24.15% të tregut.**

**Sigurimet Motorike**

Nga sigurimet motorike, grupi Eurosig-Insig ka grumbulluar 640,829 mijë lekë prime, renditur në vendin e parë në treg duke zotëruar 24.15% të tij. Totali i primeve motorike për grupin është në rritje me 3.13% krahasuar me 2025, afro 0.62% më pak se ritmi i rritjes së tregut, i cili rezulton me një rritje 3.75%.

*Grafiku 4: Struktura e tregut për sigurimin motorik, janar-shkurt 2026*




**Eurosig-Insig dominon ndjeshëm tregun në kategoritë e produkteve TPL, Karton Jeshil dhe Kufitare.**

Sipas strukturës së primeve motorike, grupi kryeson ndjeshëm tregun në sigurimet e detyrueshme motorike. Në total portofoli i sigurimeve të detyrueshme motorike është 603,994 mijë lekë, ose 25.37% e tregut të sigurimeve të detyrueshme. Pjesa më e madhe e primeve të sigurimit të detyrueshëm përbëhet nga sigurimi TPL, i cili realizon 80.12% të primeve të grupit. Grupi Eurosig-Insig në kategorinë e sigurimeve të detyrueshme motorike rritet me 3.47%, ose 20,239 mijë lekë më shumë, ardhur nga rritja e shoqërive Eurosig me 2.99% dhe rritja e Insig me 4.34%.

**Sgurimi TPL**

Shoqëria Eurosig nga sigurimi TPL ka realizuar 312,481 mijë lekë prime, të cilat janë në rritje me 5.27% nga e njëjta periudhë e vitit 2025, ose 15,161 mijë lekë më shumë. Me rritje po ashtu paraqitet edhe Insig, i cili ka realizuar 183,498 mijë lekë prime me një rritje me 5.49% ose 9,552 mijë lekë më shumë nga e njëjta periudhë e vitit 2025. Totali i primeve të grupit është 495,979 mijë lekë, renditur në vend të parë në treg me 24.16%. Krahasuar me janar-shkurt 2025, rritja është 5.35% ose 25,193 mijë lekë më shumë.

Grafiku 5: Struktura e tregut për sigurimin TPL, , jana-shkurt 2026




**Sigurimi Karton Jeshil**

Shoqëria Eurosig nga Sigurimi Karton Jeshil ka realizuar 72,646 mijë lekë prime të cilat janë në rënie me 4.91% nga e njëjta periudhë e vitit 2025 ose 3,753 mijë lekë më pak. Insig ka realizuar 26,867 mijë lekë prime me një rënie prej 1.06%

ose 289 mijë lekë më pak. Totali i primeve të grupit është 99,513 mijë lekë me një rënie prej 3.90% ose 4,041 mijë lekë më pak, renditur në vend të parë në treg me 33.99% të tij.


Grafiku 6: Struktura e tregut për sigurimin Karton Jeshil, janar-shkurt 2026




### Sigurimi Kufitare

Shoqëria Eurosig nga sigurimi Kufitar ka realizuar 5,073 mijë lekë prime te cilat janë në rënie me 9.75% nga e njëjta periudhë e vitit 2025 ose 548 mijë lekë më pak. Me rënie po ashtu paraqitet edhe Insig, i cili ka realizuar 3,429 mijë lekë prime me një rënie prej 9.62% ose 365 mijë lekë më pak krahasuar me janar-shkurt 2025. Totali i primeve të grupit është 8,502 mijë lekë me një rënie prej 9.70% ose 913 mijë lekë më pak, renditur në vend të parë në treg me 24.30% të tregut.

Grafiku 7: Struktura e tregut për sigurimin kufitar, janar-shkurt 2026



Grafiku 8: Norma e ndryshimit të sigurimeve të detyrueshme motorike , janar-shkurt 2026/2025




**Grupi Eurosig-Insig shënon rënie me 18.09% në pagesën e dëmeve për janar-shkurt 2026, krahasuar me 2025 dhe renditet në vend të dytë, duke paguar pjesë të konsiderueshme të dëmeve të tregut prej 15.74% te tij.**

## Dëme të paguara

Vlera e dëmeve të paguara nga grupi Eurosig – Insig është 202,472 mijë lekë, me një rënie rreth 18.09% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 e cila është shoqëruar me rënien e numrit të dëmeve me 18.63% ose 293 dëme më pak se 2025. Tregu i sigurimeve në vetvete shënon rritje me 15.91% më shumë se një vit më parë dhe kjo rritje shoqërohet edhe me rritjen e numrit të dëmeve të paguara për tregun në total me 4.22% ose 491 dëme më shumë se 2025 .

Raporti dëme/prime i grupit është 27.72%, ndërsa për tregun raporti rezulton 36.08%. Në totalin e dëmeve të paguara të tregut grupi Eurosig – Insig paguan 15.74% të totalit, renditur në vendin e dytë pas Sigalit.


9: Dëme të pagura nga tregu i sigurimeve të Jo Jetës, , janar-shkurt 2026



## Dëmet e sigurimeve motorike

Vlera e dëmeve të paguara nga grupi Eurosig-Insig për sigurimeve motorike është 190,223 mijë lekë duke e renditur grupin në vend të dytë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, kemi një rënie të pagesave si grup për sigurimet motorike me 19.17%, ndërsa pagesat e tregut për këtë klasë sigurimesh rriten me 2.32%. Nga totali i grupit paguhen 19.27% të dëmeve të tregut.

Grafiku 50: Dëme të paguara për sigurimin motorik , janar-shkurt 2026



**Grupi Eurosig-Insig paguan 19.27% të totalit të pagesës së dëmeve motorike dhe shënon një rritje prej 19.17% të pagesave motorike krahasuar me një vit me parë .**

**Burimi: AMF**